



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:031509
Datë: 13.12.2023
Numri i dokumentit: 05058741

PPP.nr. 200/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, në gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.G nga Gjakova, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson av.Teki Bokshi nga Gjakova, kundër debitorit Kolegji Fama me seli në Prishtinë rr. “Gustav Mayer”, nr.7 Prishtinë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Zyra për Shërbime Juridike Arche Lex, me adrese sheshi Edit Durham, 23/7 Prishtinë, në çështjen juridike përmbartimore për borxh në shumën prej 6,550.00€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.521/2020, të datës 16.12.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi në Gjakovë, jashtë seance, me datë 13.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tersi i bazuar prapësimi i debitorit Kolegji Fama me seli në Prishtinë, ashtu që:
- II. SHFUQIZOHET urdhëri përmbartimor P.nr.521/20 i datës 16.12.2020 i nxjerrë nga përmbartuesi privat Gjokë Radi në Gjakovë, anulohen të gjitha veprimet e kryera deri në këtë fazë të procedurës, si dhe përfundohet procedura përmbartimore.

A r s y e t i m

Zyra përmbartimore - Përmbartuesi Privat Gjakovë Radi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër në bazë të dokumentit përmbartimor - Vendimit të Inspektoratit të Punës MPMS nr.01/12-166/2020 të datës 08.09.2020 ashtu që ka lejuar propozimin për përmbartim dhe ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri, t’ia paguaj kreditorit shumën në vlerë prej 6,550.00€, me kamatë prej 8% duke llogaritur nga data 03.11.2020 e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 156.00€ dhe ky përmbartim do të kryhet me sekuestrimin e mjeteve financiare të debitorit nga llogaritë bankare si dhe sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme apo të paluajtshme të cilat janë në pronësi të debitorit.

Kundër urdhrit për lejim të përbarimit debitori Kolegji Fama brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim përmes të cilit e ka kundërshtuar propozimin për përbarim duke theksuar se dokumenti në bazë të të cilit është marrë udhëri përbarues nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë për faktin se në dispozitiv të vendimit nr.01/12-166/2020 të datës 08.09.2020 nuk është precizuar asnjë shumë e detyrimit financiar që debitori ka karshi kreditorit me çka rezulton se ky vendim nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Gjithashtu debitori e ka kundërshtuar kërkesën e kreditorit duke theksuar se një pjesë e kërkesës në të holla për pagat e papaguara deri në vitin 2017 është parashtruar në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës. Tutje ka shtuar se përbaruesi privat nuk ka kompetencë territoriale për të trajtuar këtë prapësim, andaj mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përbarimor P.nr.521/20, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim ku lidhur me prapësimin e debitorit ka theksuar se i njëjti është deklarativ dhe i pa qëndrueshëm. Ka shtuar se vendimi i inspektoratit të punës mbi bazën e të cilit është lejuar udhëri përbarimor është dokument i përbarueshëm me të gjitha tiparet e përcaktuara i njëjti është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm sipas LPP-së, lidhur me lartësinë e kërkesës ka theksuar se mund të argumentohet me ekspertizë financiare e cila është e domosdoshme në procedurë përbarimore me qëllim të argumentimit të lartësisë së kërkesës, mbi bazën e të lartcekurave, ka shtuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 71 i LPP-së për paraqitje të prapësimin andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet i pabazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhëri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të paraqitur nga kreditori, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Nga analizimi i propozimit për përbarim, gjykata gjeti se i njëjti është iniciuar dhe është lejuar mbi bazën e dokumentit përbarimor - vendimit të Inspektoratit të Punës MPMS nr.01/12-166/2020 të datës 08.09.2020, përmes të cilit vendim është pranuar ankesa e kreditorit B.G si e bazuar, në pikën I është konstatuar se kolegji Fama ka cenuar dispozitat e ligjit të Punës nr.03/L-212, neni 55 par. 1,2,4,5 dhe 6 dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Kontratës së Punës nr.439/0318, në pikën II është obliguar punëdhënësi Kolegji Fama që në afat prej 8 dite të bëjë përlllogaritjen dhe të ekzekutoj pagesat e mbetura borxh për kreditorin dhe në pikën III është paralajmëruar debitori se në rast se nuk ekzekutohet ky vendim do të shqiptohet masa e ndëshkimit me gjobë për mos ekzekutim të vendimit.

Ky vendim gjithashtu përmban vulën se vendimi është i formës së prerë me datë 03.11.2020 dhe vulën e ekzekutueshmërisë me datë 03.11.2020.

Gjykata vlerëson se vendimi i Inspektoratit të Punës MPMS nr.01/12-166/2020 i datës 08.09.2020, bën pjesë në grupin e dokumenteve përbarimore mbi bazën e të cilit mund të iniciohet procedura përbarimore në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1.2 i LPP-së, mirëpo gjykata vlerëson se të njëjtit i mungojnë tiparet e përshtatshmërisë që të përbarohet.

Në nenin 27 paragrafi 1 i Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përbarimore, përcaktohet se: *Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.* E që në rastin e kësaj lënde, vendimi nr.01/12-166/2020 i datës 08.09.2020 nuk përmban në dispozitiv shumën prej 6,550.00 € ashtu siç ka kërkuar kreditori në propozim për përbarim, mirëpo detyrimi i debitorit i është caktuar vetëm në drejtim të përlllogaritjes së pagave dhe të

njëjtat ti ekzekutoj tek kreditori. Caktimi i lartësisë së pagave të papaguara në shumë prej 6,550.00€ nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga Inspektorati i Punës, mirëpo kjo shumë e kërkuar nga kreditori në vendimin e inspektoratit të punës është trajtuar vetëm si pretendim.

Meqenëse se vendimi nr.01/12-166/2020 i datës 08.09.2020 mbi bazën e të cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarimore përmban detyrimin e caktuar ndaj debitorit vetëm lidhur me rrethanën që të bëj përllogaritjen e pagave të papaguara dhe të njëjta të ia paguaj debitorit në afat prej 8 dite, ndërsa objekt i kërkesës sipas propozimit për përmbarim të kreditorit është inkasimi i mjeteve financiare në shumë prej 6,550.00€, nën këto rrethana gjykata vlerëson se ky vendim nuk i përmban elementet e përcaktuara në nenin 27 par.1 të LPP-së që të përmbarohet sa i përket pagesës së shumës 6,550.00€ në emër të pagave të papaguara.

Gjykata nënvozon faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përmbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet kur: “dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”, e që në rastin e kësaj lënde përmbarimore gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor - vendimi nr.01/12-166/2020 i datës 08.09.2020 i Inspektoratit të Punës, nuk i përmban tiparet e përmbarueshmërisë gjegjësisht nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore vendosi që ta aprovoj në tersi të bazuar prapësimin e debitorit. Ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbarimore si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mbështet në nenin 73 paragrafi 4 sipas Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.200/2021, dt.13.12.2023

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.